

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / PUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/DMP
Nr. i tag. Broj. stranica Nr. yllor	02
Nr. Prot. Bi Prot. Prot. No.	03-4393/13
Data Datum Data	23.12.2013

KA.nr.1254/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare e Kolegjit, Biljana Rexhiq dhe Dalip Begaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga i pandehurit Hajdar Mehmet Loku, nga fshati Kotlinë K. Kaçanik përmes mbrojtësit Selim Idrizi- Avokat, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik-Divizioni i Kundërvajtjes, Regj.nr.2123/2012, të dt. 28.10.2013, në bazë të nenit 31 al.3, 39, dhe nenit 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më dt. 29.11.2013, merr këtë:

A K T V E N D I M

NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik-Divizioni i Kundërvajtjes, Regj.nr.2123/2012, të dt. 28.10.2013 ashtu që ndaj të pandehurit Hajdar Loku, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse, konform të nenit 198 al. 1 pika 7 lidhur me nenin 27 al. 1 të Ligjit për Kundërvajtje, për shkak të parashkrimit relativ të veprës kundërvajtëse.

Nga një kopje të aktvendimi duhet dorëzuar palëve në procedurë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik-Divizioni i Kundërvajtjes, me aktvendim, Regj.nr.2123/2012, të dt. 28.10.2013, të pandehurin Hajdar Mehmet Loku, nga fshati Kotlinë K. Kaçanik e ka shpallur përgjegjës sepse:

Si Zyrtari i Lartë Publik, në pozitën e këshilltarit komunal në Ansamblen Komunale në Kaçanik, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit, deri më datën 31.03.2012, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 par.1 e sanksionuar, sipas nenit 17 paragrafi 1. pika1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lart Publik, për të cilën kundërvajtje ia shqiptoj gjobën në shumë prej 300 (pesëqind) Euro.

Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej 5 (pesë) €.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Hajdar Loku, nga fshati Kotlinë K. Kaçanik, përmes mbrojtësit, Selim Idrizi-avokat ka paraqit ankesë për shkak të;

-vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe,

-shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse në të cilën përveç tjerash thekson se nuk ka nënshkruar asnjë formularë të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe se njoftimi me email adres dhe me gojë, nuk mund të merret si bazë për ta shpallur fajtor. Se qëllimi i tij nuk ka qenë shmangeja deklaramit ose fshehja e pasurisë, por vetëm vonesa ose neglizhenca duke mos e ditur për pasojat e saj.

Propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktvendimi i goditur të ndryshohet dhe të shpallet i pafajshëm duke e pezulluar procedurën.

Kolegji duke e vlerësuar ankesën e paraqitur aktvendimin e goditur si dhe shkresat tjera të lëndës, sipas detyrës zyrtare konstatoi se, për veprën kundërvajtëse, me të cilën ngarkohet i pandehuri ka arrit parashkrimi relativ për zhvillimin e procedurës kundërvajtëse.

Nga provat e deponuara dhe të administruara, ankesa e paraqitur si dhe nga shkresat tjera të lëndës, Kolegji, pa u lëshuar në shqyrtimin faktik të qeshjes, sipas detyrës zyrtare, konstatoj se për veprën kundërvajtëse me të cilën ngarkohet i pandehuri, ka ardhur deri te parashkrimi relativ, për shkak se; sipas shkresave të lënës, kundërvajtja, dyshohet se është kryer, me dt.31.03.2012, kurse i pandehuri është ftuar në gjykatë (sipas fletë dorëzimit) me datën 07.08.2013 (veprimi i parë procedural) dhe është marrë në pyetje, me dt.15.08.2013 dhe deri me këtë datë nuk është ndërmarr asnjë veprim procedural. Që do të thotë se ka kaluar më tepër se një vit nga data kur dyshohet se është kryer kundërvajtja e gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që ta inicoj procedurën kundërvajtëse, kohë kjo e mjaftueshme, për të arritur parashkrimi relativ i veprës kundërvajtëse sipas nenit 27 al. 1 të LK-së, i cili përcakton se; “procedura kundërvajtëse nuk mund të ndërmerret nëse kalon një vit nga koha kur është kryer së kundërvajtja”.

Në bazë të të cekurave më lartë, aktvendimi i goditur, NDRYSHOHET, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse, konform të nenit 198 al.1 pika 7 lidhur me nenin 27.al.1 të LK-së, për kundërvajtjen nga neni 17par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lart Publik, për shkak të parashkrimit relativ të veprës kundërvajtëse dhe i pandehuri Hajdar Loku, lirohet nga përgjegjësia kundërvajtëse dhe gjyba e shqiptuar.


Konform të nenit 221 të LK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS

KA. nr.1254/2013, të dt. 29.11.2013.

Procesmbajtësja
Sebahate Hoti



KRYETARJA E KOLEGJIT

